



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 900/AS-14480
Dt: 24.03.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 10 të Ligjit Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën, si dispozitive të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, duke vendosur lidhur me rekomandimin e Teatrit të qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë, për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e shfaqjes “THASHËTHEME”, me datën 24.03.2026 merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Teatrit të qytetit “Hadi Shehu” në Gjakovë, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e shfaqjes “HASHËTHEME”, për angazhimin e Shemi Avdiu në vlerë prej 3.000€, duke e mbështetur këtë aktivitet nga linja e subvencioneve të Teatrit të Qyteti “Hadi Shehu”.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të realizojë procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 3.000€ nga mjetet e subvencioneve të Teatrit të qytetit “Hadi Shehu” dhe bartjen e tyre në xhironlogarinë me numër në BPB Bank.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- Teatrit të qytetit “Hadi Shehu”
- Palës
- Arkivit.

Ardian Gjini
Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës

